



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
FIER

Nr _____ Prot

Fier, me 20.02.2017

**RAPORTI VJETOR MBI ECURINE E PUNES
SE PROKURORISE PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE FIER
PER VITIN 2016**

Drejtuar :

**PROKURORISE SE PERGJITHSHME
TIRANE**

I Nderuar zoti Prokuror i Pergjithshem !

Per vitin **2016** nga ana jone eshte kryer nje analize e detajuar veprimtarise dhe treguesve te pergjithshem te Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, ne ushtrimin e ndjekjes penale ne fazen e hetimit paraprak dhe ne fazen e gjykimit, si dhe kryerjen e detyrimeve te tjera te parashikuara ne ligj, nga prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore.

**I.DREJTIMET DHE PERPARESITE NE LUFTEN KUNDER
KRIMINALITETIT PER VITIN 2016.**

a) RESPEKTIMI TE DREJTAVE TE NJERIUT

-Ne drejtim te respektimit te te drejtave te njeriut gjate veprimtarise se Prokuroise prane Gjykates se shkalles se pare Fier, mund te thuhet me bindje te plote se jane respektuar normat Kushtetuse, Konventa per te Drejtat e Njeriut” etj. dhe nuk ka patur raste te shkeljes apo dhe cenimit sadopak te ketyre te drejtave.

Qe nga veprimet e para te kryera nga policia gjyqesore ne me te shumten e rasteve e mbikqyrur edhe nga prokuroret, dhe ne vijim nga keta te fundit jane

respektuar te gjitha detyrimet proceduriale dhe ato qe kane lidhje me te drejtat e njeriut.

b) TE MITURIT DHE GRUPET VULNERABEL, SI TE PANDEHUR DHE VIKTIMA

Ne Prokurorine prane Gjykates se shkalles se pare nuk ka seksion per te miturit.

Ne lidhje me grupet vulnerabel ka patur pak raste ku kryesisht viktimat kane qene femije te mitur sic ishte dhe rasti i nje miture te moshes 13 vjec ku nga ana jone u vleresuar maksimalisht duke i realizuar asaj gjate procesit hetimor kontakt me koordinatoren per mbrojtjen e viktimave ne Prokurorine e Pergjithshme, c'ka lehtesoi marrjen prej saj te deklarimeve rreth ngjarjes.

c) RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA

Gjate ketij viti jane mbajtur raporte korrekte me institucione te tjera, ne zbatim te ligjit procedural dhe atij organik per Prokurorine. Ne keto marredhenie rolin kryesor e zene ato qe lidhen me :

- **Prokurorine e Pergjithshme,**
- **Strukturat e policise se shtetit** dhe institucionet e tjera qe kane sherbime te policise gjyqesore, per bashkepunimin qe lidhet me fazen e hetimit paraprak te procedimeve,
- **Me Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Fier,** per fazen qe lidhet me perfaqesimin e akuzes ne gjykim,
- **Me Prokurorine dhe Gjykatën e Apelit Vlore,** per fazen qe lidhet me perfaqesimin e akuzes ne ceshtjet e ankimuar,
- Me institucione te tjera ne **nivel lokal.**

Raportet me Prokurorine e Pergjithshme.

Gjate gjithë vitit 2016 ka patur nje raportet shume te ngushte bashkepunimi me te gjitha drejtorite dhe sektoret e Prokurorise se Pergjithshme. Permiresimi i parametrave proceduriale te Prokurorise prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, eshte i lidhur drejtperdrejt me interesimin dhe mbeshtetjen e Prokurorit te Pergjithshem dhe nga ana tjeter nje gatishmeri e plote per bashkepunimin dhe ndihmen ndaj Prokurorise sone, eshte treguar edhe nga strukturat e tjera te Prokurorise se Pergjithshme, si Drejtoria e Hetimit dhe e Kontrollit te Ndjekjes

Penale te veprave te tjera dhe te te mitureve, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerezore, Drejtoria e Marredhenieve Juridiksionale me Jashte, Sektori i Pergjimeve, Drejtoria Gjyqesore dhe e Mbikqyrjes te Vendimeve Penale dhe Vuajtjes se Denimit etj.

Por po kaq e rendesishme ka qene edhe ndihma e sektoreve administrative te Prokurorise se Pergjithshme, si ato financiare, te kontrollit etj, ne mbeshtetje te nevojave tona.

Raportet me strukturat e Policise se Shtetit.

Gjate vitit 2016, pervec respektimit me rigorozitet te detyrimeve ligjore dhe ne funksion te rritjes se cilesise se hetimit paraprak, eshte synuar edhe krijimi i nje raporti te ngushte bashkepunimi me te gjitha strukturat e policise se shtetit qe veprojne ne qarkun e Fierit, si Drejtoria e Policise se Qarkut Fier dhe Komisariatet e policise ne rrethet Fier dhe Mallakaster, si dhe strukturat e policise rrugore.

Gjate vitit 2016, nga pikepamja formale, jane respektuar detyrimet ligjore, kur per procedimet penale qe jane regjistruar mbi bazen e materialit te referuar nga sherbimet e policise gjyqesore, hetimi prej prokuroreve eshte deleguar tek oficeret e policise gjyqesore te sherbimeve perkatese dhe ne disa raste (kur ka patur levizje te oficerëve te policise) jane ngarkuar edhe oficeret e policise te seksionit te prokurorise si dhe kater oficerë te D.P.Q. Fier dhe nje i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Fier, te atashuar prane kesaj prokurorie.

Por edhe nga pikepamja e efekteve mbi cilesine e hetimit paraprak, vleresimi yne eshte se eshte rritur niveli i hetimeve paraprake te kryera nga sherbimet e policise gjyqesore dhe rritur pergjegjshmeria e oficerëve te policise gjyqesore, ne raport me procedimin penal qe u delegohet per hetim.

Rritjes se cilesise se hetimit paraprak i ka sherbyer edhe institucionalizimi i takimeve te perbashketa periodike ndermjet drejtuesve te kesaj Prokurorie dhe drejtuesve te policise ne Qarkun e Fierit.

Per te gjitha seksionet e policise gjyqesore, te krijuara ne struktura jashte kesaj Prokurorie, jemi perpjekur te japim gjithe ndihmen e mundshme ne menyre qe te mundesojme kryerjen e detyres se tyre ne kushte sa me te mira.

Raportet me Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Fier

Raportet e kesaj zyre me Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Fier, kane qene korrekte dhe ligjore, ne perfaqesimin e akuzes ne kerkesat qe lidhen me fazen e hetimit paraprak dhe ate te gjykimit te procedimeve. Prokuroreve ju eshte kerkuar respektimi me korrektese i pjesemarrjes se tyre ne gjykim, nderkohe qe nga ana tjetër nga gjyqtaret eshte konstatuar angazhim i plote per mbarevajtjen e

gjykimeve, respektimin e solemnitetit te tij, arsyetimit dhe depozitimit te vendimit gjyqesor.

Nderkohe qe ka patur nje bashkepunim te mire me kryetarin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, ne rastet e trajtimit dhe pemirosimit te problematikave te vecanta qe ndonjehere jane shfaqur per ceshtjet e lartpermendura.

Raportet me Prokurorine e Apelit Vlore.

Gjate vitit 2016 ka patur nje komunikim te vazhdueshem dhe shume te ngushte si dhe me pare me Prokurorine e Apelit Vlore, ne funksion te perfaqesimit sa me cilesor te akuzes ne ceshtjet e ankimuar. Ky bashkepunim, ne respektim te percaktimeve procedurale dhe udhezimit perkates te Prokurorit te Pergjithshem eshte shtrire ne diskutimin e ceshtjeve te perfaqesuara nga prokuroret e apelit. Si rezultat i nje komunikimi te tille eshte bere e mundur qe te zgjidhen plotesisht edhe disa problematika qe haseshin ne raportet mes ketyre zyrave, lidhur me perfaqesimin e akuzes ne ceshtjet e ankimuar.

Ne funksion te ketij qellimi eshte edhe organizimi i takimeve periodike, nga Drejtuesi i Prokurorise se Apelit dhe prokuroret e kesaj prokurorie, me drejtuesin dhe prokuroret e Prokurorise se Rrethit Fier, per njohjen dhe trajtimin e problemeve te hasura ne ceshtjet e ankimuar.

Nga ana jone eshte vazhduar ndjekja e praktikës qe apelimet e prokuroreve te shkalles se pare, si per masat e sigurimit dhe per vendimet perfundimtare, krahas depozitimit ne gjykate dergohen paralelisht per njoftim edhe ne Prokurorine e Apelit, po ashtu edhe njoftimi qe Prokuroria e Apelit i dergon kesaj zyre per vendimet perfundimtare ne shkallen e dyte te gjykimit, per cdo tremujor.

Raportet me Gjykatën e Apelit Vlore.

Raportet e organit tone me Gjykatën e Apelit Vlore, kane qene teper te kufizuara, ndoshta edhe per shkak se nga Prokuroria e Apelit nuk jane dhene ne asnje rast autorizime per prokuroret tane per perfaqesimin e akuzes ne Gjykatën e Apelit, duke cmuar se edhe ky eshte nje tregues i mire i punes sone.

Raportet me Institucionet e tjera vendore.

Nga ana jone eshte treguar gatishmeri e plote per te bashkepunuar edhe me institucione te tjera si Prefektura Fier, Bashkite e Qarkut te Fierit (Fier, Ballsh, etj), ne aktivitete qe i sherbejne parandalimit te perhapjes se veprave penale, sikurse jane ato ne fushen e kultivimit dhe shperdarjes se lendeve narkotike, dhunes ne familje etj.

ç) BASHKEPUNIMI NDERKOMBETAR

Nuk kemi patur raste te bashkepunimi konkret nderkombetar pervec rasteve lidhur me marrdheniet juridiksionale me autoritetet e huaja gjyqesore te vendeve te ndryshme nepermjet Drejtorise perkatese ne Prokurorine e Pergjithshme.

d) PERDORIMI I METODAVE SPECIALE TE HETIMIT DHE HETIMET PROAKTIVE.

Në luftën kundër kriminalitetit, organi i prokurorisë është angazhuar maksimalisht ne perdorimin e metodave speciale hetimore dhe në ndërmarrjen e hetimeve proaktive më të gjithë institucionet e tjera ligjzbatuese. Per vitin 2016 jane kryer pergjime ne funksion te 11 procedimeve penale dhe 40 numra telefonik te vene ne pergjim.

dh) INFORMACION MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TE KESHILLIT TE MINISTRAVE DHE UDHEZIMEVE TE PROKURORIT TE PERGJITHSHEM TE NXJERRA NE BAZE TE TYRE.

Nga ana jone ne veprimtarine nje vjecare per vitin 2016 ne ushtrimin e ndjekjes penale deri ne fazen e gjykimit jane zbatuar me korrektese rekomandimet e Keshillit te Ministrave ne luften kunder kriminalitetit dhe ne pepruthje te plote me Udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem. Jane vleresuar drejt kushtet dhe kriteret e vendosjes se masave te sigurimit, kerkesat per masat e denimit ne gjykim ne perputhje me keto rekomandime dhe udhezimet perkatese.

e) INFORMACION STATISTIKOR MBI CESHTJET PENALE QE LIDHEN ME PROCESIN E VERIFIKIMIT TE INTEGRITETIT TE PERSONAVE QE ZGJIDHEN, EMEROHEN, OSE USHTROJNE FUNKSIONE PUBLIKE.

Nga Prokuroria e Pergjithshme, kete vit eshte percjell per ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier materiali kallezues i DAP, i cili lidhet me procesin e verifikimit te Integritetit te Personave qe Zgjidhen, Emerohen ose Ushetrojne Funkcione Publike.

Tabela e meposhteme tregon te dhenat statistikore ne lidhje me kete procedim.

Procedim i regjistruar	Neni	I pandehur	Derguar gjyqit	Martur ne gjykim
1	190/1	1	1	1

ë) PROBLEMATIKAT E HASURA

Nuk jane konstatuar problematika serioze ne lidhje me pikat e permendura me lart.

II. ANALIZA E TREGUESVE TE KRIMINALITETIT TE PUNES SE PROKURORISE

-Bazuar ne te dhenat qe do t'ju paraqisim dhe analizojme ne kete material, evidentohet se gjate vitit 2016, Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier, ka perballuar nje ngarkese pune te konsiderueshme.

Ne Prokurorine prane Gjykates se shkalles e pare Fier per vitin 2016, jane regjistruar 2404 materiale kallzimi, jane regjistruar gjate ketij viti gjithsej 1763 procedime penale, nga keto 19 te ardhura nga prokurorite e tjera, nderkohe qe ne vitin 2015 ishin regjistruar 1866 procedime penale, pra ne vitin 2016 jane regjistruar 103 procedime penale me pak se viti 2015.

Ne regjistrin e mosfillimeve gjate vitit 2016, jane regjistruar si te mosfilluara 554 kallezime penale.

Ne vitin 2016, duke perfshire tashme edhe 366 ceshtjet e mbartura, nga viti 2015, jane hetuar 2167, procedime penale, perfshi ketu edhe 38 procedime penale te rifilluara, te kaluara aktet nga gjykata dhe te shfuqizuara (3 procedime penale shfuqizuar nga gjykata dhe 3 procedime penale nga Prokuroria e Pergjithshme).

Jane mbartur ne hetim per vitin 2017, 509 procedime penale, nga keto 46 i perkasin vitit 2015 dhe viteve te tjera (te rifilluara/shfuqizuara/terhequr aktet nga gjykata).

Ne procedimet e hetuara gjate vitit 2016, eshte ushtruar ndjekja penale ndaj 1267 personave, nga keta 694 persona nen hetim.

CESHTJET E MOSFILLUARA

Ne vitin 2016, jane mosfilluar gjithsej 554 kallezime penale. Te tjerat jane ne proces verifikimi dhe nje pjese e tyre jane regjistruar si procedime penale ne vitin 2017.

Ne te gjitha rastet kur procedimet penale jane mosfilluar, pervec menyres korrekte dhe te bazuar ne ligj te vendimmarrjes dhe kohes se marrjes se saj, eshte respektuar me korrektese edhe detyrimi ligjor, per njoftimin e vendimit personave te interesuar, duke respektuar te drejten e tyre per te ushtruar ankimin ne gjykate.

Nga ana tjeter, kur nga materiali fillestar nuk kane rezultuar elemente te mjaftueshem per fillimin e ceshtjes, prokuroret dhe oficeret e policise gjyqesore kane kryer verifikimet paraprake, duke synuar respektimin e afatit kohor 30 ditor, pas te cilit, nese nuk siguroheshin te dhena te tjera, procedimet jane mosfilluar.

Ne numrin e mosfillimeve te procedimeve penale per vitin 2016, perseri si ne vitet paraardhese ka ndikuar paraqitja ne prokurori kryesisht nga ana e policise gjyqesore e materialeve te cilat : se pari nuk jane referuar per veper penale konkrete nga policia gjyqesore dhe se dyti edhe ne ato raste kur eshte referuar per veper penale konkrete, ka rezultuar se nuk ka patur elemente te veprave penale dhe materiali nuk duhej referuar, ose edhe ne rastet e veprave penale qe ndiqen me ankim direkt ne gjykate nga te demtuarit akuzues.

CESHTJET E TRANSFERUARA

Gjate vitit 2016, jane transferuar gjithsej 58 procedime penale, me 48 persona nen hetim.

Theksojme se pjesen me te madhe te ketyre procedimeve e zene ato per vepren penale te parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal dhe ato te parashikuar nga neni 145 i K.Penal.

CESHTJET E PUSHUARA

Gjate vitit 2016, jane pushuar gjithsej 300 procedime penale, nga te cilat :

- 21 procedime per mungese te faktit penal, ose sepse ky i fundit nuk parashikohet nga ligji si veper penale,
- 22 procedime per mungese te provave,
- 257 procedime per shkaqe te tjera procedurale, nder me kryesoret e te cileve e zene ato per mungese te elementeve te vepres penale dhe heqjet dore nga te demtuarit per veprat penale qe ndiqen mbi ankim.

Ne procedimet penale te pushuara :

-Eshte pushuar ndjekja penale per 245 persona nen hetim, 4 prej te cileve kane qene me mase sigurimi arrest ne burg.

Jane pushuar hetimet per 4 te pandehur (*ky procedim me 4 te pandehur ben fjale per vepren penale te parashikuar nga neni 262 i K. Penal dhe per kete jane terhequr aktet nga gjykata*).

-Per 51 prej ketyre personave hetimet jane pushuar per mungese te provave,

-Per mungese te faktit penal 13 procedime,

-181 prej tyre per shkaqe te tjera

Sa me siper eshte tregues i kujdesit te vecante qe kane treguar prokuroret qysh ne momentin fillestar te hetimeve qe, nga njera ane, te mos caktohet masa e sigurimit “arrest ne burg” pa patur prova evidente per vertetimin e akuzes dhe nga ana tjeter, qe te mos merreshin persona te pandehur pa patur nje baze te

mjaftueshme te te dhenave qe do te siguronin mbrojtjen e akuzes deri ne gjykim. Ketij qellimi i ka sherbyer edhe vijimi i praktikes per diskutimin paraprak mes prokuroreve te ceshtjes dhe drejtuesit te Prokurorise, ne momentin e caktimit te mases se sigurimit.

Per te gjitha rastet e pushimit te akuzes ose ceshtjes me persona te arrestuar jane kryer analiza dhe diskutime midis drejtuesit dhe prokuroreve e oficerave te policise gjyqesore qe kane kryer hetimet.

CESHTJET E PEZULLUARA

Gjate vitit 2016, jane pezulluar gjithsej 528 procedime penale, te gjitha keto per shkak se nuk eshte bere e mundur te zbulohet autori i vepres penale.

Treguesi i procedimeve penale te pezulluara eshte 210 procedime penale me i ulet nga viti i kaluar, por ne kete ulje theksojme se ka ndikuar fakti qe ne ne vitin 2016 jane mbartur me pak procedime.

Pavaresisht nga sa u tha me lart, bazuar ne te dhenat vjetore, pjesa me e madhe e procedimeve penale te pezulluara lidhet me vepra penale kunder pasurise dhe sidomos me vepren penale te vjedhjes. Ne keto kushte gjykojme se puna e strukturave perkatese per parandalimin dhe zbulimin e kesaj vepre penale nuk eshte ne nivelin e duhur, mangesi qe eshte evidentuar edhe ne analizen e punes per vitin 2015.

Nga ana tjeter, ne numrin e larte te vepres penale te vjedhjes, pjesen kryesore e zene vjedhjet e banesave apo te automjeteve te shtetasve. Eshte e domosdoshme qe per zbulimin e autoreve te ketyre veprave penale, qe perben nje shqetesim real per komunitetin qe perfshin qarku i Fierit, te gjitha strukturat policore, si ato per parandalimin dhe per hetimin e ketij krimi te organizojne nje pune te mirefillte profesionale, ku krahas perdorimit te mjeteve klasike per sigurimin e provave te perdorin edhe mjete te posacme per kerkimin e tyre.

Nga prokuroret eshte kerkuar ne vazhdimesi, qe te tregohet vemendja e duhur me qellim qe pezullimi i procedimit te vendosej pas kryerjes nga policia gjyqesore te gjithe veprimeve hetimore paraprake te mundshme. Pavaresisht nga sa me siper, eshte me vend te kerkohet nje vemendje me e madhe nga oficeret e policise gjyqesore, te sherbimeve dhe seksionit, gjate kryerjes se veprimeve te paperseritshme te hetimit paraprak, si kqyrja e vendit te ngjarjes, evidentimi i te gjitha gjurmeve dhe sendeve te gjetura aty, marrja e provave materiale, me qellim qe numri procedimeve penale te kesaj natyre, te vije duke u zvogeluar.


PROCEDIMET PENALE TE DERGUARA PER GJYKIM

Ne vitin 2016, jane derguar per gjykim gjithsej 742 procedime penale, me 847 persona te pandehur.

Nder te pandehurit, 247 prej tyre kane qene me mase sigurimi arrest ne burg, 13 arreste ne shtepi, 257 detyrim paraqitje, 7 ndalime per te dale jashte shtetit, 9 qendrime ne nje vend te caktuar, 1 garanci pasurore dhe 9 masa mjekesore.

Jane derguar per gjykim 4 procedime me 5 te pandehur nga procedimet e rifilluara ne vitin 2016,

Grafiku i meposhtem tregon ne perqindje statusin e procedimeve penale te hetuar ne vitin 2016



Gjate ketij viti jane perfaqesuar ne gjykate nje numer i konsiderueshem i ceshtjeve per te cilat prokurori thirret si person i trete ose ndiqet me kerkese ne Gjykate dhe theksojme se ky numer kete vit ka qene shume i larte duke krahasuar me vitet e meparshme, ku pjesen me te madhe e zene kerkesat e te burgosurve gjate vuajtjes se denimit ne IEVP Fier. Per 600 ceshtje eshte nxjerre nga Drejtuesi i Prokurorise “Vendimi per Caktimin e Prokurorit” ne lidhje me keto gjykime.

Nisur sa me siper, per periudhen njevjecare te vitit **2016** (*duke perfshire mosfillimet, pushimet, pezullimet, transferimet, derguar gjyqit, dhe bashkuar*), jane perfunduar 2212 ceshtje penale, nga te cilat 1658 procedime penale me 1155 persona, nder te cilet 847 te pandehur dhe 308 persona nen hetim.

Rezultoni se ne vitin 2016, jane filluar kryesisht, 45 procedime penale, nga 36 qe ishin ne vitin 2015. Jane paraqitur 1216 referime nga policia e shtetit, 179 kallezime nga shtetasit, 6 ankime nga shtetasit, 854 materiale me vendngjarje dhe 65 nga nenpunes publik, 10 nga Policia Financiare, 13 nga OSHEE, 16 nga Policite e tjera.

TREGUESIT E ARRESTIMEVE NE FLAGRANCE DHE NDALIMEVE

Per vitin 2016, treguesit e arrestimeve ne flagrance dhe ndalimeve, te kryer ndaj shtetasve te dyshuar per kryerjen e veprave te ndryshme penale, paraqiten si me poshte :

Jane arrestuar ne flagrance nga policia gjyqesore 492 shtetas,

Jane ndaluar nga policia gjyqesore 48 shtetas,

Eshte nxjerre urdher ndalimi nga prokurori per 17 shtetas

Per 1 person te arrestuar ne flagrance apo te ndaluar nga policia gjyqesore, prokurori ka disponuar per lirimin e menjehershem, ndersa nga ana e Gjykates per 3 persona eshte vendosur te ndiqen ne gjendje te lire.

Eshte kerkuar ne gjykate vleresimi i arrestimit ne flagrance apo ndalimit per 556 persona, nder te cilet gjykata ka vleresuar te ligjshem 547 dhe te paligjshem 9 te tilla. Ne lidhje me keto te fundit, theksojme se paligjshmeria sipas gjykates ka konsistuar ne intepretimimin e kohes se kapjes se personit me p/verbalin e arrestimit ne flagrance, te cilat kane diference midis tyre ne nje apo dy ore.

Fakti kur arrestimi ne flagrance apo ndalimi nuk eshte vleftesuar i paligjshem ne asnje rast nga prokuroret dhe qe vetem per 9 raste eshte vleftesuar i paligjshem nga gjykata, cmojme se eshte nje tregues pozitiv ne kete drejtim.

Per vitin 2016, treguesit e kerkesave te prokurorit per masat kryesore te sigurimit, paraqitet si me poshte vijon :

-Nga prokurori eshte kerkuar ne gjykate per 318 persona caktimi i mases se sigurimit “arrest ne burg”, nderkohe qe gjykata e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj 227 personave,

-Nga prokurori eshte kerkuar ne gjykate per 41 persona caktimi i mases se sigurimit “arrest ne burg ne mungese”, nderkohe qe gjykata e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj 40 personave,

-Nga prokurori eshte kerkuar per 5 person caktimi i mases se sigurimit “arrest ne shtepi”, nderkohe qe gjykata e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj 12 personave,

-Nga prokurori eshte kerkuar per 10 persona caktimi i mases se sigurimit “arrest ne burg me afat”, nderkohe qe gjykata e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj 10 personave,

-Nga prokurori nuk eshte kerkuar per asnje persona caktimi i mases se sigurimit “garancia pasurore”, nderkohe qe edhe gjykata e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj 1 personi,

-Nga prokurori eshte kerkuar per 216 persona caktimi i mases se sigurimit “detyrim per paraqitjen ne policine gjyqesore”, nderkohe qe gjykata e ka caktuar ate mase sigurimi ndaj 294 personave.

TE DHENA PER FAZEN E E EKZEKUTIMIT

Gjate vitit 2016, jane nxjerre gjithsej 1140 urdhera ekzekutimi, ne krahasim me 1063 te nxjerra ne vitin 2015, nga keto 351 urdhera jane me burgim, 380 me pezullim burgimi, 176 me gjobe, 233 urdhera te ndryshem kryesisht shpenzime proceduriale, masa mjekesore dhe shuarje mase sigurimi.

Per sa i perket kriminalitetit sipas shtrirjes territoriale konstatohet se territori qe perfshin Bashkia e Fierit ze numrin me te madh te veprave penale.

Lidhur me gjendjen e kriminalitetit gjate vitit 2016 veprat penale te cilat zene numrin me te madh te procedimeve penale te regjistruara jane Kreu II, Kreu III dhe Kreu VIII.

Vihet re nje ulje e veprave penale te Kreut te II “Veprat penale kunder personit” te Kodit Penal, gjithsej regjistruar 209 procedime penale.


Ne lidhje me Kreun e III te Kodit Penal, “Veprat penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike”, jane regjistruar 776 procedime penale.

Ne lidhje me Kreun e VIII te Kodit Penal “Veprat kunder autoritetit shteteror” jane regjistruar 677 procedime penale.

Grafiku i meposhtem tregon kriminalitetin sipas struktures se Kodit Penal, te procedimeve penale te hetuara gjate vitit 2016 ne Prokurorine prane Gjykates se Shkalles se Pare Fier.

KRIME/ KUNDËRVAJTJE

KUNDRAVAJTJE
13%



III. TREGUESIT STATISTIKORE 2 VJECAR TE VEPRAVE PENALE .

KRIME KUNDER JETES ME DASHJE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj. ¹	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja ²	3		1							
Neni 77 Vrasja per nje krim tjetër										
Neni 78 Vrasja me paramendim	2	1	1	1	3	1	1		2	
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje										
Neni 79 Vrasja ne rrethana cilesuese	4	2	3	2	1	2	2	1	3	4
Neni 79/a Vrasja e funksionareve publike										
Neni 79/b Vrasja e punonjeseve te Policise se Shtetit										
Neni 79/c Vrasja per shkak te marrëdhënieve familjare	2		2					1		
Neni 80										
Neni 81 Vrasja e foshnjes										
Neni 82 Vrasja ne tronditje psikike										

¹ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.

² Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (65 procedime regjistruar dhe 60 pandehur regjistruar).

Neni 83 Ne kapercim mbrojtjes nevojshme										
Neni 83/a Kanosje per hakmarrje/ gjakmarrje										
Neni 83/b Nxitja per gjakmarrje										
Neni 84 Kanosja	31	20	28	20	15	23	6	22	9	12
Totali	42	23	35	23	19	26	9	24	14	16

KRIME KUNDER JETES SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia		1		1	1					
Totali	0	1	0	1	1	0	1	0	1	1

V.P. K/SHENDETIT ME DASHJE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj. ³	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 86 Tortura										
Neni 87 Tortura me pasoja te renda										
Neni 88 Plagosje e rende	5	4	9	7	4	6	4	4	4	3
Neni 88/a Plagosje e rende tronditje psikike										
Neni 88/b P.R. ne kapercim te mbrojtjes										
Neni 89 Plagosje e lehte me dashje	28	24	41	42	42	26	13	34	14	13
Neni 89/a										
Neni 90 Demtime te tjera										
Totali	33	28	50	49	46	32	17	38	18	16

³ Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.

VEPRA PENALE KUNDER SHENDETIT TE KRYERA NGA PAKUJDESIA	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rende nga pakujdesia										
Neni 92 Plagosja e lehte nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali										

VEPRA PENALE QE RREZIKOJNE JETEN DHE SHENDETIN NGA NDERPRERJA E SHTATZANISE OSE NGA MOSDHENIA E NDIHMES	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Nderprerja e shtatzanise pa pelqim te gruas										
Neni 94 Nderprerja e shtatzanise e kryer ne vende dhe nga persona te paautoriz.										
Neni 95 Dhenia e mjeteve per nderprerjen e shtatzanise						2		1		
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshem	1	1		3	3					
Neni 97 Mosdhenia ndihme										
Neni 98 Mosdhenia e ndihmes nga kapiteni i anijes										
Neni 99 Shkaktimi i vetevrasjes	7		1		1	11	1	1	1	1
Totali	8	1	1	3	4	13	1	2	1	1

KRIME SEKSUALE	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar

Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me te mitur	1		1		1					
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhune me te mitur te moshes me 14-18 vjeç	1		2							
Neni 102 M. Seksuale me dhune me te rritura	1	2	1	2	1	1	1	2	1	
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhune me te rritur										
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazote per t'u mbrojtur										
Neni 104 Marredhenie seksuale ose homoseksualeme kerkcenim me perdorimin e armes										
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shperdoruar detyren										
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona ne gjini ose ne kujdestari										
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike										
Neni 108 Vepra te turpshme	1	1	1	1	1	1		1		
Neni 108/a Ngacnimi Seksual	1	2	1	3	1	3	1	3	1	2
Totali	5	5	6	6	4	5	2	6	2	2

VEPRA PENALE KUNDER LIRISE SE PERSONIT	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 109 Rrembimi ose mbajtja peng e personit										
Neni 109/a Rrembimi ose mbajtja peng e personit ne rrethana lehtesuese										
Neni 109/b Shtrengimi me ane te kanosjes ose dhunes per dhenien e pasurise										
Neni 109/c Zhdukja me force										
Neni 110 Heqja e paligjshme e lirise	6	6	11	12	9	2	1	2	1	8
Neni 111 Rrembimi i avioneve, anijeve dhe mjeteve te tjera										
Neni 112 Dhunimi i baneses	1			2		2	1	3	1	
Totali	6	6	11	14	9	4	2	5	2	8

VEPRA PENALE KUNDER MORALIT DHE DINJITETIT	2015					2016				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenu ar
Neni 113 Prostitucioni				5					15	19
Neni 114 Shfrytezimi i prostitucionit	6	3	5	3		3	1	2	1	3
Neni 115 Mbajtja e lokaleve per prostitucion										
Neni 117 Pornografia	4									
Neni 118 Dhunimi i varreve	4	1	1	1		2	3	1	3	1
Neni 119 Fyerja										
Neni 120 Shpifja										
Neni 121 Nderhyrje te padrejta ne jeten private										
Neni 121/a Perndjekja	8	4	7	4	4	3	4	3	4	4
Neni 122 Perhapja e sekreteve vetjake										
Neni 123 Pengimi ose shkelja e fshehtesise se korrespondences										
Totali	22	8	13	13	4	8	8	6	23	27

VEPRA PENALE KUNDER FEMLJEVE, MARTESES DHE FAMILJES	2015					2016				
	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pandenu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pandenu ar
Neni 124 Braktisja e femijeve te mitur	4	1	4	1	1	6		6		
Neni 124/b Keqtrajtimi i te miturit	3	3	2	3	1	2		4		1
Neni 125 Mosdhenia e mjeteve per jetese										
Neni 126 Mosnjoftimi i ndryshimit te vendbanimit	1		1		1	1		1		
Neni 127 Marrja e padrejte e femijes										
Neni 128 Nderrimi i femijeve										
Neni 128/a Fshehja ose nderrimi me dashje I femijes										
Neni 129 Shtytja e te miturve ne krim	1	1	1	1	1					
Neni 130 Shtrengimi ose pengimi per te bashkejetuar ose per te zgjidhur martese										
130/a Dhuna ne familje	117	108	145	131	95	105	85	112	92	89

Totali	126	113	153	136	99		114	85	123	92	90
---------------	------------	------------	------------	------------	-----------	--	------------	-----------	------------	-----------	-----------

VEPRA PENALE KUNDER LIRISE SE BESIMIT	2015					2016				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 131 Pengimi i veprimtarive te organizatave fetare										
Neni 132 Shkaterrimi ose demtimi i objekteve te kultit										
Neni 133 Pengimi i ceremonive fetare										
Totali	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

VJEDHJA E PASURISE ⁴	2015					2016				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 134 Vjedhja	438	78	73	94	98	473	59	63	64	64
Neni 135 Vjedhja e kryer duke shperdoruar detyren	23	18	12	24	17	7	4	3	4	12
Neni 136 Vjedhja e bankave dhe e arkave te kursim.										
Neni 137 Vjedhja e energjise elektrike ose impulseve telefonike	53	67	54	68	69	27	29	26	30	37
Neni 137 /a Vjedhja e rrjetit te komunikimeve elektronike	1									
Neni 138 Vjedhja e veprave te artit e kultures										
Neni 139 Vjedhja me dhune	12	4	9	7	15	10	4	7	8	4
Neni 140 Vjedhja me arme	3	2	7	5	1	1	2		2	1
Neni 141 Vjedhja me pasoje vdekjen										
Neni 142 Sigurimi i mjeteve per vjedhje									1	2
Totali	530	169	155	198	200	518	98	99	109	120

MASHTRIMET	2015	2016
-------------------	-------------	-------------

⁴ Vecuar nga ky grup dhe trajtuar me vete trafiket

	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand . Per gjyki m	Nr. Pand denu ar		Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand . Per gjyki m	Nr. Pand denu ar
Neni 143 Mashtrimi	37	15	24	23	7		30	15	17	17	11
Neni 143/a Skemat mashtruese dhe piramidale											
Neni 143/a/1 Manipulimi i tregut		1		1	1						
Neni 143/a/2 Perdorimi i paautorizuar dhe perhapja e informacionit te privilegjuar											
Neni 143/a/3 Manipulimi i cmimeve dhe perhapja e informacionit te rreme											
Neni 143/a/4 Paraqitja e te dhenave te rreme dhe shperndarja e paautorizuar e tyre											
Neni 143/a/5 Regjistrimi i titujve ne burse ne menyre te paautorizuar											
Neni 143/a/6 Fshehja e pronesise											
Neni 143/a/7 Tregtimi i paligjshem i titujve											
Neni 144 Mashtrimi ne subvencione											
Neni 144/a	1		2								
Neni 145 Mashtrimi ne sigurime		1		1			38	1	27	1	2
Neni 146 Mashtrimi ne kredi											
Neni 147 Mashtrimi per veprat e artit e te kultures											
Neni 148 Botimi i vepres se tjetrit me emrin e vet											
Neni 149 Riprodhimi pa te drejte i vepres se tjetrit	3		2								
Neni 149/a Shkelja e te drejtave te pronesise industriale	1	4	1	4	4		5		5		
Neni 149/b Shkelja e te drejtave te topografise se qarkut te gjysmepercuesit											
Totali	42	21	29	29	12		73	16	49	18	13

SHKATERRIMI I PRONES	2015					2016				
	Nr. Proc d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand per gjyki m	Nr. Pand denu ar	Nr. Proce d Regj	Nr. proce d per gjyki m	Nr. i pand . Regj.	Nr. Pand . Per gjyki m	Nr. Pand denu ar
Neni 150 Shkaterrimi i prones	10	4	6	5	9	24	4	4	4	3
Neni 151 Shkaterrimi i prones me zjarr	25	2	3	2	2	19				1
Neni 152 Shkaterrimi i prones me eksploziv										
Neni 153 Shkaterrimi i prones me permytje										
Neni 154 Shkaterrimi i prones me mjete te tjera	1									
Neni 155 Shkaterrimi i rrugeve	10					1				
Neni 156 Shkaterrimi i rrjetit elektrik	15					4	1	1	1	

Neni 157 Shkaterrimi i rrjetit te ujitjes	2		1							
Neni 158										
Neni 159 Shkaterrimi i rrjetit te ujesjellesit	3	9	4	9	7	1				4
Neni 160 Shkaterrimi i veprave kulturore	1									
Neni 161 Shkaterrimi i prones nga pakujdesia	7	1	11	2		1				1
Neni 162 Perplasja e mjeteve te transportit masiv										
Totali	74	16	25	18	18	50	5	5	5	9

VEPRA PENALE TE KRYERA NE SHOQERITE TREGTARE	2015					2016				
